



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo




Komuna e Rahovecit / Opštine Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam

Department of Economy, Development and Tourism



-III- Nr. i prot. 5109 Më 09.11 20 22
Br. prot. Dt.
RAHOVEC - ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 16 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve Nr. 1427 të datës 28.04.2017, për destinimin e mjeteve nga fondi për transfer dhe subvencione, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm në Komunën e Rahovecit, bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Rahovecit, përkatësisht Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, përmes kësaj thirrjeje ju bën ftesë publike të gjithë përpunuesve të pemëve dhe perimeve, të regjistruara në Republikën e Kosovës që veprojnë brenda territorit të Komunës së Rahovecit, të aplikojnë për të përfutur nga skema e mbështetjes e cila do të ofrohet përmes subvencioneve me mjete financiare.

Qëllimi

Në vitet e fundit përpunimi i produkteve bujqësore ka ndikuar në masë të madhe në ndaljen e importit të pemëve dhe perimeve nga shtetet fqinje, duke kontribuar në të ardhurat e kënaqshme dhe siguri më të madhe për prodhuesit vendor. Qëllimi i kësaj thirrjeje publike është përkrahja financiare për përpunuesit e pemëve dhe perimeve, që bëjnë përgatitjen, ruajtjen dhe konservimin e tyre, duke nxjerr nënproduktet, sikurse janë: ajvari, turshitë, reçeli, pekmezi etj.

Bizneset përpunuese të pemëve dhe perimeve - në kuadër të së cilës bëjnë pjesë:

- Grumbullimi i pemëve dhe perimeve;
- Përpunimi i produkteve bujqësore;
- Ruajtja dhe konservimi i pemëve dhe perimeve;
- Fuqizimi i eksportit;
- Rritja e numrit të punëtorëve.

Specifikat e tjera të thirrjes publike

KOMUNA RAHOVEC

- Thirrja publike për aplikim hapet më: 09.11.2022 dhe mbyllet më 23.11.2022
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim, nuk do të pranohen.
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Rahovecit dhe përfituesi i subvencionit do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- Me secilën përfitues të subvencionit do të nënshkruhet një kontratë ndërmjet përfituesit të mjeteve financiare dhe mbështetësit financiar.
- Përfituesi në fund të vitit është i obliguar që të sjell raport detal për sasinë e grumbulluar të pemëve/perimeve

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit

- Certifikata me numër të regjistrimit të biznesit (NUI)
- Kopja e letërnjoftimit të pronarit;
- Konfirmimi i llogarisë bankare në emër të biznesit;
- Vërtetimin nga ATK-ja;
- Listën e fermerëve nga të cilët ka pranuar produkte bujqësore për vitin 2022;
- Dëshmi për pagesën e taksave komunale;
- Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë.

Buxheti

Shuma e ndarë e buxhetit për këtë thirrje është: **28,000.00€**

Kategorizimi i subvencionimit - kriteret

Përmes kësaj thirrjeje subvencionet do të ndahen në 3 kategori:

1. Kategoria e parë:
 - Bizneset që kanë të regjistruar mbi 10 punëtorë;
 - Bizneset që kanë grumbulluar më shumë se 500,000 kg të perimeve (lloje të ndryshme);
 - Bizneset që gjatë vitit 2022 kanë realizuar së paku eksport në shtetet e jashtme.
2. Kategoria e dytë:
 - Bizneset e regjistruara nga 2 deri në 9 punëtorë;
 - Bizneset që gjatë vitit 2022 kanë grumbulluar deri 499,999 kg të perimeve (lloje të ndryshme).
3. Kategoria e tretë:
 - Bizneset fillestare që gjatë vitit 2022, kanë arritur të përpunojnë mbi 10,000 kg të perimeve etj.

Mënyra e aplikimit

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,

KOMUNA RAHOVEC

- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimet, në katin e parë në objektin e Komunës.



KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm